

4599/14
17.11.2015



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr.Regj. Themeltar 9427

Date 12.05.2015

Nr. 2356 Vendimi

Date 05.11.2015

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata Administrative e Apelit e perbere nga gjyqtaret :

KRYESUES : ARTUR MALAJ

ANETARE : LINDITA SINANAJ

ANETARE : ALKELINA GAZIDEDJA

asistuar nga sekretare gjyqesore Ermelinda Nuraj, ne dhome keshillimi te dates 05.11.2015, mori ne shqyrtim çeshjen qe u perket paleve :

PADITESE : Shoqeria “OSHAFI 2011” sh.p.k

TE PADITUR : Drejtoria Rajonale e Tatimore Berat
Drejtoria e Apelimit Tatimor Tirane

OBJEKTI : Shfuqizimin e njoftimit te vleresimit te Detyrimit Tatimor nr. 3003 prot., dt. 02.07.2013 te Drejtorise Rajonale te Tatimeve Berat, si dhe te Vendimit nr. 21364/1 prot., dt. 22.10.2014 te Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane “Per lenien ne fuqi te gjobes ne shumen 4.454.234 leke ».

Sigurimin e padise.

Pezullimin e ekzekutimit te detyrimit te Njoftimit te Detyrimit Tatimor nr. 3003 prot., dt. 02.07.2013, si dhe te Vendimit nr. 21364/1 prot., dt. 22.10.2014 te Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane deri ne perfundim te gjykimit.

BAZA LIGJORE : Ligji nr. 49/2012 “Per Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarveshjeve Administrative“ nenet 2, 7, 10, 11, 15, 17/a, 18, 21, 28/1, 29, 30/a, 34, 35, 40/a; Nenet 45, 66, 116, 117, 118, 137 e vijues te K.Pr.Administrative; Ligji nr. 9920, date 9.05.2008 neni 16, pika 3/c pika 4, neni 18, 80, 106, 107; Udhezimi nr. 24, dt. 02.09.2008 te Ministrit te Financave.

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore me vendimin Nr. 133, dt. 04.02.2015, ka vendosur:

- Pranimin e kerkesepadise si te bazuar ne prova dhe ne ligj.
- Shfuqizimin e Njoftimit te Vleresimit Tatimor nr. 3003, dt. 02.07.2014 te Drejtorise Rajonale te Tatimeve Berat, si dhe te Vendimit nr. 12547 prot., dt. 29.10.2014 te Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane “Per lenien ne fuqi te gjobes ne shumen 4.454.234 leke (katermilione e katerqind e pesedhete e kater mije e dyqind e tridhete e kater) leke”.
- Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te pales se paditur.
- Urdherohet Zyra e permbarimit me zbatimin e ketij vendimi nga dita qe vendimi te marre forme te prere.
- Ndaj ketij vendimi nuk nxirret urdher ekzekutimi.
- Ligjerimin e mases se sigurimit te padise te vendosur me vendimin nr. 200, date 25.11.2014.

Kunder vendimit Nr. 133, dt. 04.02.2015, te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Vlore, ka paraqitur ankim pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat, qe kerkon prishjen e vendimit dhe lenien ne fuqi te akteve administrative si te drejta dhe te bazuar ne ligj, duke parashtruar keto shkaqe:

- Pretendimet qe paraqet pala paditese subjekti "OSHAFI 2011" shpk, ne kerkese padine e tij, me objekt: "Shfuqizim te akteve administrative, sipas Njoftimit vleresimiti nr.3003 prot., date 02.07.2014 dhe vendimit nr.21364/1 prot., date 22.10.2014 te Drejtorise se Apelimit Tatimor ne DPT Tirane, bazuar ne rezultatet e Raportit te Kontrollit te dates 01.07.2014", pohojme se, pretendimet qe parashtron paditesi nuk perbejne argumente ligjore, si dhe ai nuk paraqet asnje prove ligjore ne favor te pretendimeve te tija.
- Raporti i kontrollit u krye ne baze te Autorizimit per kryerjen e kontrollit me Nr. 1242 prot., date 21.05.2014. Kontrolli u krye sipas programit te kontrollit me objekt: „- T.V.SH Nentor 2013 - Prill 2014; - Sigurimet Shoqerore dhe Shendetesore Nentor 2013 - Prill 2014; - Tatim Fitimi per vitin 2013“. Me ane te Formular Kontrolli 10, subjekti eshte njoftuar per: kontrollin qe do te kryhet; objektin e kontrollit; inspektorin qe do te kryej kontrollin; gjithashtu subjekti eshte njoftuar se ky kontroll do te filloj ne oren 10.00, prane residences se subjektit ne daten 23.05.2014 dhe do te mbaroje me date 30.05.2014.
- Ne perfundim te kontrollit eshte hartuar raporti i kontrollit, nga ku rezulton se: „Nga verifikimi i llogarise "kliente" per vitin 2013, ka rezultuar se vlere prej 45.000.000 leke eshte arketuar nepermjet arkesh dhe jo nepermjet sistemit bankar. Sa me siper, shoqeria ka bere shkelje te Ligjit Nr.9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, neni 59 "Pagesat me para ne dore". Pra, ne baze te ligjit shoqeria vlere te tilla te trasaksioneve duhet ti kryej nepermjet sistemit bankar dhe jo me para ne dore. Per kete arsye shoqeria eshte denuar me gjobe, bazuar ne nenin 120 "Pagesat ose arketimet me para ne dore mbi vleren 150.000 leke".
- Theksojme se ne lidhje me ate c'ka pretendohet nga paditesi, (qe klientet e huaj nuk jane te detyruar te zbatojne ligjet shqiptare), bejme me dije gjykaten se ky eshte nje pretendim i pabazuar ne ligj, ai (paditesi) nuk ka cituar asnje ligj fiskal, apo nene te ligjit ku te theksohet qe subjektet e huaja qe blejne mallra ne teritorin e Republikes se Shqiperise (kryerjen e trasaksioneve me Subjekte Shqiptare) nuk i nenshtrohen ligjeve Shqiptare. Bejme me dije gjykates se nuk ekziston ndonje marreveshje tatimore e ratifikuar nga Kuvendi i Shqiperise qe te shmange detyrimin e subjekteve te huaja per te respektuar dhe zbatuar ligjet shqiptare dhe ne rastin konkret per te bere kalimin e trasaksioneve nepermjet rrugeve bankare. Per kete arsye pretendimet qe paditesi paraqet nuk qendrojne dhe nuk perbejne argument ligjore per ta shkarkuar ate nga pergjegjesia.

- Per sa i perket pretendimit se: "Natyra e shitjes se mallrave mund ta detyrojne shoqerine "Oshafi 2011" sh.p.k qe blesit e produkteve mund te paraqiten ne mestdite ose ne ditet e pushimeve (e shtune e diel) kur bankat jane te mbyllura, gje qe e bene te pamundur pagesen e mallit nga ana e porositesit ta kryej me veprime bankare siç e kerkon ligji", nuk perben argument ligjor, qe te justifikoj veprimin e jashteligjshem te shoqerise, duke kryer transaksione me vlera mbi 300 mije leke nepermjet arkes (para ne dore) dhe jo nepermjet sistemit bankare. Ne Raportin e Kontrollit nuk eshte trajtuar likujdimi i bere nga shoqeria ne adrese te faturave ne rruge jo bankare, por eshte trajtuar likujdimi qe klientet kane bere ne favor te shoqerise "Oshafi 2011", jo ne rruge bankare por nepermjet arkes. Pra pretendimet qe paraqet paditesi nuk perben argument ligjore per te kundershuar shkeljet e konstatuara.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Pasi degjoi relatimin e gjyqtarit Artur Malaj ne dhome keshillimi:

V E R E N

Rrethanat e faktit :

Paditesi, Shoqeria „Oshafi 2011” sh.p.k, eshte Subjekt i regjistruar ne Q.K.R Berat ne daten 05.05.2011, me numrin unik te identifikimit te subjektit NIPT L 12905003 A. Veprimtaria e ketij subjekti eshte: Tregtimi me shumice dhe pakice, import-eksport i prodhimeve bujqesore, prodhimeve blegtorale, pemtarise, ullirit, agrumeve, vreshtarise etj, me Administrator Z.Nurçe Oshafi.

Rezulton se prane pales se paditur eshte ushtruar kontroll me objekt: „- T.V.SH Nentor 2013 - Prill 2014; - Sigurimet Shoqerore dhe Shendetesore Nentor 2013 - Prill 2014; - Tatim Fitimi per vitin 2013“. Me ane te Formular Kontrolli 10, subjekti eshte njoftuar per: kontrollin qe do te kryhet; objektin e kontrollit; inspektorin qe do te kryej kontrollin; gjithashtu subjekti eshte njoftuar se ky kontroll do te filloj ne oren 10.00, prane residences se subjektit ne daten 23.05.2014 dhe do te mbaroje me date 30.05.2014.

Ne perfundim te kontrollit te ushtruar pala e paditur ka nxjerre Njoftim vleresimin tatomor nr.3003 prot., date 02.07.2014 ku pala paditese detyrohet ne nje shume prej 4.454.234 leke. Ky detyrim ka dale ne baze te Raportit te Kontrollit te dates 01.07.2014", nga ku rezulton se: Nga verifikimi i llogarise "kliente" per vitin 2013, ka rezultuar se vlera prej 45.000.000 leke eshte arketuar nepermjet arkesh dhe jo nepermjet sistemit bankar. Sipas pales se paditur shoqeria ka bere shkelje te Ligjit Nr.9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, neni 59 "Pagesat me para ne dore".

Ne mbeshtetje te Nenit 83 te ligjit nr.9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" paditese ka kundërshtuar detyrimet (gjore) e nxjerra me anen e observacionit te dorezuar prane Drejtorise Rajonale te Tatimeve Berat ne dt. 16.04.2014.

Observacioni qe eshte bere nga shoqeria "Oshafi 2011" sh.p.k nuk eshte marre ne konsiderate nga ana e inspektorese se kontrollit, prane Drejtorise se Rajonale Tatimore Berat:

Ne baze te ligjit nr. 9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne R.Shqiperise" neni 106 piket 1.a te Udhezimit nr. 24, date 02.09.2008 te Ministrit te Financave, i ndryshuar ne zbatim te ketij ligji, paditese ka bere me shkrim kundërshtimin e Njoftim Vleresimi Tatimor Nr. 3003, date 02.07.2013 te Drejtorise Rajonale Berat ne Drejtorine e Apelit Tatimor Tirane. Nga ana e Drejtorise se Apelit Tatimor Tirane eshte kthyer pergjigja me shkresen nr. 1425 prot., dt 29.10.2014, e cila ka lene ne fuqi njoftimin e vleresimit te detyrimit tatimor te Drejtorise Rajonale te Tatimeve Berat nr. 3003, dt 02.07.2014.

Pretendimet e pales paditese :

Pala paditese ka pretenduar se, per te gjitha rastet e konstatuara ka kryer shitje me subjektet te huaja, per te cilin per çdo raste ka prere fature te regullt me TVSH dhe nuk jane te detyruar klientet e huaj, te cilet nuk jane regjistruar ne Republiken e Shqiperise, te zbatojne ligjin shqiptar.

Sipas pretendimeve te pales paditese, shoqeria ka deklaruar ne dogane dhe zoteron deklarata doganore orgjinale te eksportit.

Gjithashtu, pala paditese ka pretenduar se, referuar nenit 59 pika 1, 2 te ligjit 9920 "Per Profedurat Tatimore ne R.Shqiperise" dhe udhezimit nr. 24, dt. 02.09.2008 te Ministrit te Financave, i ndryshuar shoqeria "Oshafi 2011" sh.p.k nuk i eshte shmangur ketij ligji, pasi zoteron deklaratat doganore te eksportit te shoqeruar me faturat tatimore te TVSH.

Pretendimet e pales se paditur :

Pala e paditur ka pretenduar se, shoqeria eshte denuar me gjobe, bazuar ne nenin 120 "Pagesat ose arketimet me para ne dore mbi nen 150.000 leke".

Ne lidhje me pretendimin e paditesit se, klientet e huaj nuk jane te detyruar te zbatojne ligjet shqiptare, sipas pales se paditur nje pretendim i tille eshte i pabazuar ne ligj, pasi paditesi nuk ka cituar asnje ligj fiskal apo nen te ligjit, ku te theksohet qe subjektet e huaja qe blejne mallra ne fentorin e Republikes se Shqiperise nuk i nenshtrohen ligjeve shqiptare.

Gjithashtu, pala e paditur ka pretenduar se, ne Raportin e Kontrollit nuk eshte trajtuar likuidimi i bere nga shoqeria ne adrese te fermereve ne rruge jo bankare, por eshte trajtuar likuidimi qe klientet kane bere ne favor te shoqerise "Oshafi 2011", jo ne rruge bankare por nepermjet arkës.

Sipas pales se paditur, te vetmet raste perjashtimore ne zbatimin e gjobave jane parashikuar ne Udhezimm nr.24, date 02.09.2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH", paragrafi 120.1 dhe nga rrethanat e parashikuara nga tatimpaguesi ne kerkese padine e tij, nuk jane pjese e rasteve perjashtimore te percaktuara ne dispozitat e mesiperme.

Vleresimi i Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Vlore :

Gjykata ka cmuar se duhet te pranoje kerkesepadine si te bazuar ne prova dhe ne ligj. Nga kontrolli i ushtruar nga inspektoria ka rezultuar se shoqeria "Oshafi 2011" sh.p.k ka patur vleren totale prej 44.542.336 leke xhiro vjetore dhe per rrjedhoje kjo inspektore ka aplikuar gjoben 10% te vleres totale ne shumes 4.454.234 leke, e barabarte me 4.454.234 leke. Gjykata ka cmuar se kjo gjobe duhet te shfuqizohet.

Gjykata ka konstatuar se, per te gjitha rastet shoqeria ka kryer shitje me subjektet e huaja, per te cilin per çdo raste ka prere fature te regullt me TVSH dhe nuk jane te detyruar klientet e huaj, te cilet nuk jane regjistruar ne Republiken e Shqiperise, te zbatojne ligjin Shqiptar.

Faturat e prera jane te konfirmuara nga organet doganore dhe per rrjedhoje nuk kemi shitje brenda vendit per te cilen citon ligji nr. 9920, dt 19.05.2008 "Per Proçedurat Tatimore ne R.Shqiperise", si dhe Udhezimi nr. 24, dt. 02.09.2008 te Ministrit te Financave. Ne rastin konkret, Shoqeria "Oshafi 2011" sh.p.k ka deklaruar ne dogane dhe zoteron deklarata doganore orgjinale te eksportit. Vete natyra e shitjes se ketyre mallrave mund ta detyrojne shoqerine "Oshafi 2011" sh.p.k qe blesit e produkteve mund te paraqiten ne mesnate ose ditet e pushimeve (e shtune e diel) kur bankat jane te mbyllura, gje qe e bene te pamundur pagesen e mallit nga ana e porositesit ta kryej me veprim bankar siç e kerkon ligji. Ne keto kushte, shoqeria eshte e detyruar qe blesit te beje pagim te blerjes se mallit ne arken e shoqerise, pasi aktualisht ne kete zone rurale dhe konkretisht fshati Dronovice, Komuna Kutalli, Berat nuk mbulohen me sistem bankar.

Shoqeria " OSHAFI" sh.p.k ka marre shumen 44.542.336 (Dyzet e kater milion e peseqind e dyzete e dymije e treqinde e tridhete gjashte) leke nga klientet, por ka kryer dhe likuidimin e furnitoreve, pra te Fermereve ne vleren 56.714.219 (Pesedhete e gjashtemilion e shtateqind e katermbedhjetmije e dyqind e nentembedhjet) leke, te cilen nuk mund te lene mallin pa i likuiduar ne moment, pasi perfaqesojne nje numer te madh te fermereve te zones. Keta fermere nuk kane numra llogarie ne banke apo te regjistrua ne organet tatimore, te cilat jane nen vleren 300. 000 (Treqindemije) leke.

Vleresimi i Gjykates Administrative te Apelit :

Së pari Gjykata vlerëson të evidentojë kompetencën e saj për shqyrtimin e ankimit objekt i këtij gjykimi. Në referim të nenit 7, nenit 10 paragrafi 2 germa "a" dhe nenit 44 te ligjit Nr. 49/2012, kjo gjykate ka kompetencën lëndore dhe funksionale për gjykimin e kësaj çështjeje.

Së dyti gjykata vlerëson te marre në shqyrtim kushtet e pranueshmërisë së ankimit. Sikurse është referuar edhe me sipër ne këtë vendim, rezulton që ankimi, është paraqitur brenda afatit pesëmbëdhjete ditor të përcaktuar në nenet 443 paragrafi i parë e 444 paragrafi i parë të K.Pr.Civ.

Po kështu, nuk rezulton te ekzistojnë kriteret penguese te parashikuara ne nenin 45 te ligjit Nr. 49/2012 qe e bëjnë vendimin te paankimueshem. Ankimi rezulton të jetë i plotë edhe në elementet e tjerë, si ne elementet e formës edhe te përmbajtjes, lidhur me nënshkrimin nga pala qe e ka paraqitur, tregimin e palëve ndërgjyqëse, vendimin kundër te cilit është paraqitur ankimi, apo kërkimet për te cilat është paraqitur ky ankim. Për të gjitha këto, gjykata çmon se ankimi i paraqitur, objekt gjykimi, duhet te pranohet për shqyrtim.

Së treti, procedura e zhvillimit te këtij gjykimi rezulton te jete ne përputhje te plote me dispozitat e Kodit te Procedurës Civile. Nuk konstatohen shkelje si ne procedurën e zhvillimit te gjykimit edhe ne procedurën e marrjes se vendimit nga gjykata e shkalles se pare.

Në analize te pretendimeve te paraqitura ne ankim, Gjykata Administrative e Apelit, vlerëson se Vendimi i Gjykes Administrative te Shkalles se Pare Vlore eshte marre ne zbatim te dhe interpretim te gabuar te ligjit dhe si i tille do te ndryshohet dhe do te rrezohet padia per arsyet e mëposhtme:

Nga ana e pales se paditur eshte ushtruar kontroll ne Shoqerine "Oshafi 2011" sh.p.k. Ne perfundim te kontrollit eshte hartuar raporti i kontrollit, nga ku rezulton se: „Nga verifikimi i llogarise "kliente" per vitin 2013, ka rezultuar se vlere prej 45.000.000 leke eshte arketuar nga shoqeria paditese nepermjet arkes dhe jo nepermjet sistemit bankar.

Ne nenin 59 dhe 120 te Ligjit Nr.9920,date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, parashikohet se:

Neni 59/1. " Tatimpaguesit, persona fizikë apo juridikë, tregtarë, nuk mund të kryejnë ndërmjet tyre transaksione shitjeje ose blerjeje me para në dorë, kur vlere e transaksionit është më e madhe se 300 000 lekë ".

Neni 120 : " *Tatimpaguesit, që janë persona fizikë apo juridikë, tregtarë, që kryejnë transaksione shitjeje apo blerjeje me para në dorë, për shuma, që tejkalojnë 300 000 lekë, dënohen me gjobë, në masën 10 për qind të vlerës së secilit transaksion ".*

Ne rastin ne shqyrtim rezulton se pala paditese ka kryer shkelje te Ligjit Nr.9920,date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, neni 59 "Pagesat me para ne

dore“ ne lidhje me nenin 120. Pra, ne baze te ligjit shoqeria vlera te tilla te trasaksioneve duhet ti kryej nepermjet sistemit bankar dhe jo me para ne dore. Per kete arsye shoqeria me te drejte eshte denuar me gjobe, bazuar ne nenin 120 te Ligjit Nr.9920, date 19.05.2008 “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise“ i ndryshuar.

Eshte i gabuar arsyetimi i Gjykates se Shkalles se Pare se klientet e huaj nuk jane te detyruar te zbatojne ligjet shqiptare. Ky eshte nje pretendim i pabazuar ne ligj. Nuk ka asnje ligj fiskal, apo nene te ligjit ku te theksohet qe subjektet e huaja qe blejne mallra ne teritorin e Republikes se Shqiperise (kryejne trasaksioneve me subjekte Shqiptare) nuk i nenshtrohen ligjeve Shqiptare. Nuk ekziston ndonje marreveshje tatimore e ratifikuar nga Kuvendi i Shqiperise qe te shmange detyrimin e subjekteve te huaja per te respektuar dhe zbatuar ligjet shqiptare dhe ne rastin konkret per te bere kalimin e trasaksioneve nepermjet rrugeve bankare. Per kete arsye pretendimet e paditesit te pranuar pa ndryshim edhe ne vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare nuk qendrojne dhe nuk perbejne argument ligjore per ta shkarkuar ate nga pergjegjesia. Per sa i perket pretendimit se: “Natyra e shitjes se mallrave mund ta detyrojne shoqerine “Oshafi 2011” sh.p.k qe bleresit e produkteve mund te paraqiten ne mestdite ose ne ditet e pushimeve (e shtune e diel) kur bankat jane te mbyllura, gje qe e bene te pamundur pagesen e mallit nga ana e porositesit ta kryej me veprime bankare siç e kerkon ligji”, nuk perben argument ligjor, qe te justifikoj veprimin e jashteligjshem te shoqerise, duke kryer transaksione me vlera mbi 300 mije leke nepermjet arkës (para ne dore) dhe jo nepermjet sistemit bankare.

Pala paditese ka pretenduar gjithashtu se: Shoqeria “ OSHAFI” sh.p.k ka marre shumen 44.542.336 (Dyzet e kater milion e peseqind e dyzete e dymije e treqinde e tridhete gjashte) leke nga klientet, por ka kryer dhe likuidimin e furnitoreve, pra te fermereve ne vleren 56.714.219 (Pesdhjete e gjashtemiljon e shtateqinde e katermbedhjetmije e dyqind e nentembedhjet) leke, te cilen nuk mund te lene mallin pa i likuiduar ne moment, pasi perfaqesojne nje numer te madh te fermereve te zones. Keta fermere nuk kane numra llogarie ne banke apo te regjistrua ne organet tatimore, te cilat jane nen vleren 300. 000 (Treqindemije) leke.

Lidhur me kete pretendim Gjykata cmon se : Ne Raportin e Kontrollit nuk eshte trajtuar likuidimi i bere nga shoqeria ne favor te klienteve te vet ne adrese te faturave ne rruge jo bankare, por eshte trajtuar likuidimi qe klientet kane bere ne favor te shoqerise “Oshafi 2011”, jo ne rruge bankare por nepermjet arkës. Pra pretendimet qe paraqet paditesi nuk perben argument ligjore per te kundërshtuar shkeljet e konstatuara.

PER KETO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar ne nenin 50/1/c te Ligjit nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative"

VENDOSI

- Ndryshimin e Vendimit te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Vlore nr. 133, dt. 04.02.2015, ne kete menyre:
- Rrezimin e padise se paditesit Shoqeria " Oshafi 2011 " shpk.
- Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te pales paditese.
- Kunder ketij vendimi lejohet rekurs ne Gjykatën e Larte, Kolegji Administrativ brenda 30 diteve nga komunikimi i vendimit.

- U shpall, sot me date 05.11.2015, ne Tirane.

ANETARE

ALKELINA GAZIDEDJA

dv

ANETARE

LINDITA SINANAJ

dv

KRYESUES

ARTUR MALAJ

dv

Vertetohet njesia me origjinalin

*Kancelari
Leonard Steaty
Steaty*